REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 47, datë 01/10/2004

"MBI
NJË SHTESË TË STRUKTURËS SË CIRKUT TË TIRANËS
DHE BUXHETIT TË TIJ ME QËLLIM
RIORGANIZIMIN E ORKESTRËS FRYMORE TË TIRANËS"

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot më datë 01/10/2004, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinise dhe Sporteve, në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "ç", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 "Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.726, dt.21/12/2000 "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.297, dt.27/06/2002, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.656, dt.25/09/2003, indeksuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.184, dt.10/04/2004,

V E N D O S I;

1. Të krijohet Sektori i Orkestrës Frymore duke u përfshirë në strukturën e Cirkut të Tiranës.

2. Kjo strukturë do të ketë në përbërje të saj një përgjegjës sektori me pagesë për kohë pune të plotë, sipas lidhjes Nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi, si dhe 49 instrumentistë me pagesë 2500 lekë për çdo aktivitet që do të kryejnë, por jo më shumë se 5000 lekë në muaj.

3. Efektet financiare të pikës 2 në shumën 5.500.000 lekë do të përballohen duke pakësuar fondin rezervë të të ardhurave, duke shtuar buxhetin e Cirkut të Tiranës për vitin 2004 në total 5.500.000 lekë, nga të cilat artikulli 600 (paga) në shumën 85.000 lekë, artikulli 601 (sigurime shoqërore) në shumën 25.000 lekë, artikulli 602 (shpenzime operative) 3.100.000 lekë, si dhe artikulli 231 (investime) në shumën 2.290.000 lekë.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Cirkut të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI